



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 6004 Prot. datë 06.09.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3608 Prot. datë 05.04.2018



URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 158, datë 05.04.2018

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2018 – 2019 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “ç” të pikës 2 të nenit 26, e të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J M Ë:

1. Struktura e vitit shkollor 2018 – 2019 të jetë si më poshtë:

1.1. Në arsimin bazë

a. Mësim

Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 13 qershor 2019.

b. Pushime

Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019.

c. Provime

Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 14 - 30 qershor 2019.

1.2. Në arsimin e mesëm të lartë

a. Mësim

Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 20 qershor 2019.

Për maturat, viti shkollor fillon më 17 shtator 2018 dhe mbaron më 7 qershor 2019.

b. Pushime

Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019.

c. Provime

Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 8 - 30 qershor 2019.

1.3. Në arsimin profesional

a. Mësim:

Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe përfundojnë:

- a.1. Më 20 qershor 2019, për nxënësit e klasave të 10-ta (për të gjitha strukturat), për nxënësit e klasave të 12-ta (për strukturën 2+2) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (për strukturën bllok 4-vjeçare).

- a.2. Më 7 qershor 2019, për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (struktura 2+1+1) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta (struktura 2+2).
- a.3. Më 7 qershor 2019, për të gjithë nxënësit maturantë.

b. Pushime:

Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019.

c. Provime

- c.1. Provimet përfundimtare të Nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 10 - 21 qershor 2019.
- c.2. Provimet përfundimtare të Nivelit III zhvillohen në periudhën 10 - 14 qershor 2019.
- c.3. Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 8 - 30 qershor 2019.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri: Ministria e Arsimit, Sportit, dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë arsimore vendore dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

Arben AHMETAJ



**MINISTRI I ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË**

Lindita NIKOLLA

